

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	PDK-ja konteston konstituimin e Kuvendit në Gjykatën Kushtetuese
ADRESA	https://www.koha.net/lajmet-e-mbremjes-ktv/pdk-ja-konteston-konstituimin-e-kuvendit-ne-gjykatën-kushtetuese
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 01:37:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 17:08:16 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	604db0410183b3389d2c4025b27b6e81a5f66f5d8c3da2cc3b4d183d22f45a51
TEKSTI	0157fb368e027327ebaa9905b8402db3f35b2322ba8b9c8a5c2513ab0f08e51f
PAMJA	55e2e18e60f62dec526bfe5cb6501d28f83a2a3d159d542758545f97a5018dcb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9db9edda4d9bfaa366f4959efc3d7b0d3b0583a64e907d61d3a8100643b8fddd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	339a441950953cdd8a76a2c095ab2238d5bab62fcc252abcef1242a6a5fba2fb
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9db9edda4d9bfaa366f4959efc3d7b0d3b0583a64e907d61d3a8100643b8fddd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LAJMET E MBRËMJES

PDK-ja konteston konstituimin e Kuvendit në Gjykatën Kushtetuese



Foto: Driton Paçarada

Nga: Rrezon Gashi

14 shtator 2026 19:08

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Tri shkelje i kanë evidentuar deputetët e Partisë Demokratike në procesin e konstituimit të Kuvendit. E me kërkesën për t'i dhënë sqarim, të hënën, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese. E për një çështje tjetër kanë paralajmëruar se do t'i drejtohen Gjykatës të martën

Një ditë pasi kryetarja Albulena Haxhiu e shpalli Kuvendin të konstituuar, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për ta interpretuar kushtetutshmërinë e procesit.

Deputeti nga radhët e PDK-së, Arian Tahiri, tha se në lëndën e dorëzuar të hënën është përfshirë edhe kërkesa për vendosjen e masës së përkohshme deri në marrjen e një vendimi meritore.

“Fillimisht të vendoset masa, në mënyrë që të mos prodhohen dëme e situata më të rënda në kuptim juridik-institucional. Sepse qeveria që është zgjedhur dhe nga kuvendi që nuk është realisht i konstituuar dhe nuk ka ligjshmëri për ta votuar qeverinë, mundet të vazhdojë të marrë vendime të jashtëligjshme. Për të gjitha këto ne do t'i drejtohem gjykatës, për secilin vendim të jashtëligjshëm në mënyrë që vendi të kthehet në binarë kushtetues”, ka thënë Tahiri.

Të dielën, pa u zgjedhur nënkryetari që i takon PDK-së dhe 37 ditë pas skadimit të afatit kushtetues, Haxhiu e shpalli Kuvendin të konstituuar. Në një seancë tjetër, po atë ditë, u votua edhe qeveria.

Por sipas deputetit Përparim Gruda, jurist me profesion, pushteti i Vetëvendosjes nuk ka legjitimitet.

Edhe



Arbëri • 15 o. më parë

Konstituimi i Kuvendit përfundon në Kushtetuese

Arbëri.

Mustafa: Jam takuar me Kurtin për ta diskutuar platformën time për zhbllokimin institucional

Futboll.

Newcastle pëson debakël nga Leeds

Futboll.

Spektakël në Serie A, Interi fiton 5:3 ndaj Udineses

Futboll.

Kosova i luan 4 ndeshje brenda 16 ditësh grumbullim

Arbëri.

VV-ja pas tërheqjes së Sejdiut: Ishte mundësia që çështja e presidentit të zgjidhej, por u bllokua sërish

LAJMET E MBRËMJES.

Mbrojtja kërkon lirimin e Thaçit e katër të tjerëve në rastin për pengim të drejtësisë

“Në një demokraci kushtetuese, legjitimiteti nuk buron vetëm nga vota, vetëm nga numrat. Në demokraci kushtetuese, legjitimiteti i institucioneve të shtetit buron nga respektimi i Kushtetutës po ashtu. Prandaj kjo qeveri ka problem dhe ky pushtet në tërësi ka problem me kushtetutshmërinë dhe legjitimitetin e vet”, ka deklaruar Gruda.

Gruda tha se të martën do t’i drejtohen Kushtetueses edhe lidhur me formimin e qeverisë.

E avokati Faton Fetahu u shpreh se procesi i konstituimit të Kuvendit është përcjellë me tri shkelje.

Sipas tij, e para lidhet me mosrespektimin e afatit kushtetues për zgjedhjen e kryetarit dhe pesë nënkryetarëve, jo më larg se 30 ditë nga certifikimi i rezultateve zgjedhore. E dyta, me mosrespektimin e Rregullores së Kuvendit, e cila kërkon që ndërprerjet e seancës konstituive të mos zgjasin më shumë se 48 orë. Para vazhdimit të saj më 9 shtator, seanca ishte ndërprerë më 8 gusht, pra për 768 orë.

Si shkelje të tretë, Fetahu e konsideroi moszgjedhjen e nënkryetarit nga radhët e PDK-së, pasi u konsiderua se kjo parti ka hequr dorë nga e drejta për propozim.

“Refuzim nuk mund të konsiderohet mosparaqitja fizike e deputetëve tanë në sallën e Kuvendit, sepse të njëjtit paraprakisht kanë paralajmëruar se për qëllim sqarimin dhe parashtrimin në Gjykatën Kushtetuese do të përmbahen nga dhënia e propozimit të tyre, një e drejtë ekskluzive kushtetuese”, ka thënë Fetahu.

Edhe



Arbëri • 13 sht 2026

PDK-ja nesër i drejtohet Kushtetueses

Haxhiu u zgjodh kryetare e Kuvendit në seancën e 9 shtatorit. Nënkryetari nga Vetëvendosja, Ardian Gola, mori votat të premtën, ndërsa kandidatja e PDK-së, Vlora Çitaku, nuk u votua nga deputetët e shumicës.

Në vazhdimin e seancës të dielën u zgjodhën edhe Kujtim Shala nga Lidhja Demokratike, Tanja Vujoviq nga Lista Serbe dhe Emilja Rexhepi nga komunitetet e tjera joshumicë.

#PDK

#KONSTITUIMI I KUVENDIT

#GJYKATA KUSHTETUESE

Artikuj të ngjashëm



LAJMET E MBRËMJES • 13 sht 2026

PDK-ja e AAK-ja kontestojnë konstituimin e Kuvendit dhe votimin e Qeverisë



Arbëri • 13 sht 2026

Gruda: Kuvendi s’mund të konsiderohet i konstituuar pa u zgjedhur nënkryetari nga radhët e PDK-së



Arbëri • 13 sht 2026

PDK-ja s’merr pjesë në seancë, tërheq përkohësisht kandidaturën e Çitakut, do t’i drejtohet Kushtetueses



Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografite, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kat i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.